



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr. 2013 Prot

Vlorë, më 29.09 .2025

VENDIM

Nr. 19 , datë 25.09 .2025

PËR
MIRATIMIN E STUDIMIT TË KOSTOVE TË SHËRBIMIT PËR
MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE NË BASHKINË E HIMARËS

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 25.09 .2025 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, pikës 5, 7 të nenit 13, Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” i ndryshuar si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë Nr. 44, datë 13.08.2025 (Nr. 6485 Prot, datë 19.08.2025) “Për miratimin e Studimit të Kostove të Shërbimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në Bashkinë e Himarës”,

VENDOSI;

1. Të miratojë Studimin e Kostove të Shërbimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në Bashkinë e Himarës.
2. Bashkëlidhur Studimi i Kostove të Shërbimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në Bashkinë e Himarës.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social në institucionin e Këshillit të Qarkut Vlorë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi në mbështetje të pikës 3, nenit 78 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.

KRYETARI

Eryis Moçka



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shpresën Nr. _____ Prot, datë _____ .2025.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkivlore.gov.al
E-mail: info@qarkivlore.gov
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

RELACION

Të Nderuar Këshilltarë!

Pranë institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë është protokolluar me tonën Nr. 1884 Prot, datë 17.09.2025, shkresa e Bashkisë Himarë Nr. 7034 Prot, datë 17.09.2025, me lëndë "Dërgim i dokumentacionit për miratimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve të Bashkisë Himarë", bashkëlidhur së cilës gjendet Vendimi i Këshillit Bashkiak Himarë Nr. 44, datë 13.08.2025 (Nr. 6485 Prot, datë 19.08.2025) "Për miratimin e Studimit të Kostove të Shërbimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në Bashkinë e Himarës".

Në mbështetje të legjislacionit në fuqi, Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, Bashkia Himarë duke patur në vëmendje mbajtjen pastër të mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, ruajtjen e burimeve natyrore, hierarkinë në menaxhimin e mbetjeve, promovimin e ekonomisë, turizmit si dhe parimin "ndotësi pague", me mbështetjen e Projektit "Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta dhe Ekonomia Ricikluese në Respekt të Mjedisit", ka hartuar Studimin e Kostove të Shërbimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në Bashkinë e Himarës.

Nëpërmjet Studimit të Kostove të Shërbimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në Bashkinë e Himarës, bashkia synon të minimizojë ndikimin e mbetjeve në mjedis, përmirësimin e përdorimit efikas të burimeve përmes reduktimit, ripërdorimit, riciklimit.

Vendimi i Këshillit Bashkiak Himarë Nr. 44, datë 13.08.2025 (Nr. 6485 Prot, datë 19.08.2025) "Për miratimin e Studimit të Kostove të Shërbimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në Bashkinë e Himarës", është vlerësuar i ligjshëm nga Prefekti i Qarkut Vlorë, me shkresë Nr. 830/1 Prot, datë 25.08.2025.

Mëshetur në pikën 7, nenit 13 "Procedurat për hartimin dhe miratimin e planeve rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve", të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" i ndryshuar, Plani Vendor i Menaxhimit të mbetjeve hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga Këshilli i Qarkut, ndaj Ju ftojme që të procedojmë me miratimin e këtij projektvendimi.

Sekretar i Këshillit të Qarkut

Vllasi Nasaj

Drejtor i Drejtorisë së Finacës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social

Anisa Hyseni

Jurist

Alma Myrtaj

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov
Tel: +355 33 421 600